

LIGJ**Nr.10 081, datë 23.2.2009****PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:****KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1**

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.

Neni 2

Objekti dhe fusha e veprimit

1. Ky ligj përcakton:

- a) parimet për përcaktimin e veprimtarive, të veprimeve dhe tipave të të mirave publike, ushtrimi, kryerja dhe përdorimi i të cilave u nënshtronet licencimit, autorizimit apo lejimit;
- b) parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave, autorizimeve e lejeve dhe parimet për shkaqet e procedurat e revokimit të tyre;
- c) organizimin dhe përbajtjen e Regjistrat Kombëtar të Licencave dhe Lejeve;
- ç) procedurat për trajtimin e disa licencave, të autorizimeve dhe lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore;
- d) rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Licencimit.

2. Ligji është i zbatueshëm për:

- a) të gjitha licencat e autorizimet, për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe të çdo natyre tjetër të ngjashme, përvëç atyre të natyrës vetjake;
- b) të gjitha lejet për përdorimin e të mirave publike, për qëllime të veprimtarive të sipërpërmendura, përvëç përdorimit të të mirave publike për qëllime vetjake.

Neni 3

Përkuftim i termave

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Ministria" është ministria, që mbalon çështjet e ekonomisë.
- b) "Ministër" është ministri që mbalon çështjet e ekonomisë.
- c) "Ministër përgjegjës" është ministri që mbalon fushën e veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi, për një licencë/autorizim/leje të caktuar.
- ç) "Institucion qendror" është Këshilli i Ministrave, çdo ministri dhe çdo institucion publik në varësi të tyre.
- d) "Institucion i pavarur" është çdo institucion i pavarur, sipas Kushtetutës apo i kriuar me ligj dhe çdo organ i njësive të pushtetit vendor, që ka në kompetencë dhënien e një licence, autorizimi apo lejeje.
- dh) "Institucion tjetër" është çdo institucion qendror ose i pavarur, që ka kompetenca të caktuara për verifikimin e përbushjes së kritereve të licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe çdo subjekt privat, të cilit i është dhënë, sipas ligjit, një kompetencë e tillë.
- e) "Veprimtari" është çdo veprimtari e natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprimtari tjetër e ngashme, që nuk është e natyrës vetjake.
- ë) "Veprim" është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngashhëm, që nuk është i natyrës vetjake, i cili kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie, që licencohej apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mire publike, që i nënshtronhet apo jo pajisjes me leje.
- f) "E mirë publike" është pronë e paluajtshme publike e shtetit, sipas legjislacionit përkatës, si dhe të mira të tjera të natyrës publike, si: ajri, ujërat, burimet natyrore, mjedisi, në përgjithësi, trashëgimia kulturore, frekuanca dhe të tjera të kësaj natyre, sipas legjislacionit në fuqi.
- g) "Përdorim i së mirës publike" është e drejta për të administruar një të mirë publike, për të gëzuar fryshtet e saj, për t'i ndryshuar karakteristikat fizike, për ta përdorur si lëndë, për të përdorur hapësirën për ndërtim, për të shkarkuar mbetje në mjedis, si dhe forma të tjera përdorimi të këtyre natyrave, për qëllimet apo nevojat e një veprimtarie, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.
- gj) "Licencë" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtë të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
- h) "Autorizim" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtë të kryejë një apo disa veprime, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
- i) "Leje" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtë të përdorë një të mirë publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
- j) "Titullar i licencës/autorizimit/lejes" është personi juridik apo personi fizik, që ka marrë një licencë, autorizim apo leje.
- k) "Kushte të licencimit/autorizimit/lejimit" janë ato kushte, përbushja paraprake dhe/ose në vazhdimësi e të cilave nga titullari i licencës/autorizimit/lejes është e detyrueshme.
- l) "Kritere të licencimit/autorizimit/lejimit" është ajo pjesë e kushteve, nga përbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës/autorizimit/lejes.
- ll) "Detyrime të licencimit/autorizimit/lejimit" është ajo pjesë e kushteve, që kerkohen të përbushen përgjatë kryerjes së veprimtarisë, të veprimit apo përdorimit të së mirës publike.
- m) "Dokument provues" është akti shkresor i një institucioni publik, privat apo akti i përgatitur nga vetë kerkuesi e që provon përbushjen e një kushti licencimi/autorizimi/lejeje.
- n) "Dokument tjetër shoqërues" është një dokument i detyrueshëm për t'u paraqitur, për pajisjen me licencë/autorizim/leje e që nuk është dokument provues.
- nj) "Dokumente shoqëruese" janë dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese e të marra së bashku.
- o) "Kerkues" është personi fizik apo juridik, që kerkon pajisjen me licencë, autorizim apo leje.
- p) "QKL" është Qendra Kombëtare e Licencimit.

Neni 6

Parimet përcaktimin e veprimtarive që u nënshtrohen licencimit dhe autorizimit

Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi nëpërmjet licencimit apo, përkatësisht, autorizimit bëhet vetëm nëse plotësohen këto dy rrethana:

- a) ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunkcionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat socialë dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre;
- b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në shkronjën "a" të këtij nenit, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëpasshëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përbushjes së disa kritereve të paracaktuara, përpresa fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit.

Neni 7

Parimet përcaktimin e veprimtarive që i nënshtrohen lejes

Përdorimi i një të mire publike, nëpërmjet një lejeje, bëhet vetëm nëse plotësohet, të paktën, njëra nga këto rrethana:

- a) kur nëpërmjet procesit të dhënies së lejes, synohet marrja e kundërvleftës më të mirë në interes publik;
- b) përdorimi i lirë i së mirës publike nga subjekte, që nuk zoterojnë njohuritë, teknologjitet apo garanci të tjera të nevojshme, shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj ose një shfrytëzim të papërshtatshëm;
- c) kur e mira publike, për shkak të kufizimit të saj në sasi, shtrirje, hapësirë apo kohë, ose për shkak të rrethanave të tjera, të arsyeshme, nuk lejon, përvëçse një numër të kufizuar përdoruesish apo përdorim të kufizuar, ose kur përdorimi i lirë i së mirës publike nga një numër i pakufizuar subjektesh apo pa kufizim në sasi dhe/ose shtrirje në hapësirë dhe/ose kohë shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj apo një shfrytëzim të papërshtatshëm.

Neni 8

Parimet përcaktimin e kushteve të licencimit/autorizimit

1. Kushtet e licencimit apo autorizimit bazohen në parimet e proporcionalitetit, deburokratizimit dhe uljes së barrierave administrative.

2. Kushtet e licencimit apo autorizimit duhet t'u përgjigjen, në mënyrë të përshtatshme, interesave publikë që ato garantojnë dhe mund të jenë: aftësi profesionale apo fizike, përvojë apo njohuri, mënyrë organizimi, zotërimi i një teknike apo teknologjije të caktuar, gjendje apo garanci pasurore, gjendje juridike apo norma të sjelljes e të etikës.

3. Kushtet e licencimit apo autorizimit përcaktohen e shprehen, bazuar në tregues objektivë, të matshëm, të thjeshtë e të kuptueshëm.

4. Çdo kërkues, që plotëson kriteret e licencimit apo autorizimit, fiton të drejtën që ta ushtrojë atë veprimtar apo, përkatësisht, ta kryejë atë veprim.

5. Përjashtimisht, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, sipas nenit 6 të këtij ligji, mund të përcaktohet një kufizim sasior i veprimtarive apo veprimeve, nëpërmjet kufizimit të numrit të licencave pér atë veprimtar, apo autorizimeve pér atë veprim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij nenit, nisma ligjore përcakton që licenca apo autorizimi i jepet një numri të kufizuar kërkuesish që, përvëçse plotësojnë kriteret bazë të licencimit apo, përkatësisht, autorizimit, arrijnë, gjithashtu, vlerësimin më të mirë, krahasuar me kërkuesit e tjerë, në përputhje me disa kriterë dhe procedura konkuruese, të paravendosura, transparente e të drejta.

Neni 9

Parimet përcaktimin e kushteve të lejimit

1. Kushtet e lejimit, për çdo lloj të mire publike, bazohen në parimet e ruajtjes, të shtimit dhe mirëpërdorimit të së mirës publike, maksimizimit të përfitimit publik, si dhe të proporcionalitetit, deburokratizimit dhe mosdiskriminimit të padrejtë.
2. Kushtet e lejimit përcaktohen e shprehen bazuar, sa më shumë të jetë e mundur, në tregues objektivë, të matshëm, të krahasueshëm, të thjeshtë e të kuptueshëm.
3. Kriteret e lejimit duhet t'u përgjigjen, në mënyrë të përshtatshme, interesave publikë, që garantojnë dhe mund të janë kualifikuese dhe/ose konkurruese.
4. Kriteret kualifikuese shërbejnë për të përgjedhur kërkuesit, që përbushin kërkuesat minimale dhe/ose të domosdoshme për përdorimin e së mirës publike. Vlerësimi i plotësimit të kritereve kualifikuese mund të jetë pjesë e një procesi lejimi ose një procesi paraprak licencimi. Në këtë rast, licencimi është kusht paraprak, i domosdoshëm për lejimin.
5. Kriteret konkurruese shërbejnë për të përcaktuar kërkuesin, që ofron përdorimin më të përshtatshëm dhe/ose kundërvlefët më të mirë, krahasuar me kërkuesit e tjerë, që kanë përbushur kriteret kualifikuese. Konkurrimi bazohet në procedura e kritere të paravendosura, transparente e të drejta.

Neni 10

Parimet përcaktimin e procedurave të licencimit, autorizimit dhe lejimit

1. Vlerësimi i plotësimit të kritereve të licencimit, të autorizimit apo dhënies së lejes bazohet, sipas rastit, në: vetëdeklarimet e kërkuesit, dokumentet e lëshuara nga organe të tjera publike apo institucionet e tjerë private, kryerjen e vlerësimeve, inspektimeve paraprake apo organizimin e testimeve, të provimeve, garave, intervistave, dëgjimit ose të metodave të tjera të përshtatshme.
2. Procedurat për trajtimin e kërkuesave për licenca, autorizime e leje duhet të janë të qarta, të thjeshta, transparente dhe të mbështeten, sa më shumë të jetë e mundur, në:
 - a) miratimin e heshtur;
 - b) mjetet elektronike të informimit e të komunikimit, përfshirë aplikimin on line;
 - c) modelin e qendrës me një ndalesë;
 - c) shkëmbimin e integruar të informacionit e të dokumentacionit ndërmjet organeve publike;
 - d) pagesën për shërbimin administrativ të licencimit/autorizimit/lejes, kur parashikohet, e cila duhet të mbulojë vetëm koston dokumentare;
 - dh) taksat dhe/ose tarifat për dhënien e licencave/autorizimeve/lejeve, kur parashikohen, duhet të janë të arsyeshme e në funksion të arritjes së qëllimeve të këtyre instrumenteve.

Këto procedura duhet të kryhen në kohën më të shkurtër të mundshme.

3. Kur dokumentet që provojnë përbushjen e kritereve të licencimit, autorizimit apo lejes ose të dhënat e deklaruara nga kërkuesi janë në regjistrat elektronikë të institucioneve publike dhe janë të aksesueshme nga organi publik, ku bëhet kërkesa, kërkuesi nuk detyrohet t'i paraqesë ato dokumente, me kushtin që ai të tregojë partë në kërkësë-referencën e këtyre të dhënavët në regjistrin përkatës.
4. Organet publike, që kanë kompetencë në procesin e dhënies së licencave, autorizimeve apo lejeve, në çdo rast, sigurojnë, nëpërmjet faqeve të tyre zyrtare të internetit dhe mjeteve të tjera të përshtatshme, informimin e plotë të të interesuarve e të publikut për kuadrin ligjor, kriteret, procedurat, afatet, format e aplikimit dhe dokumentet shoqërues të kërkua, si dhe ofrojnë shërbime këshillimi për kërkuesin.

Neni 11

Parimet për përcaktimin e afateve të vlefshmërisë së licencës, autorizimit dhe lejes

1. Afati i parashikuar i vlefshmërisë së licencës/autorizimit/lejes duhet të jetë i përshtatshëm për arritjen e qëllimit.
2. Vlefshmëria e një licence duhet të jetë, si rregull, pa afat e, në rast të kundërt, afati të jetë aq më i gjatë, sa ka arsyë të besohet se kushtet e licencimit do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre, në mënyrë të përshtatshme, përgjatë këtij afati.
3. Afati i vlefshmërisë së një lejeje duhet të jetë aq i gjatë, sa ka arsyë të besohet se kushtet e lejimit do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre, në mënyrë të përshtatshme, përgjatë këtij afati.
4. Afati i vlefshmërisë së një autorizimi duhet të jetë aq i gjatë, sa të lejojë kryerjen normale të veprimit të autorizuar.

Neni 12

Parimet për përcaktimin e shkaqeve dhe të procedurave, për revokimin e licencës/autorizimit/lejes

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.
2. Konstatimi i mosplotësimit të kritereve apo shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit ex poste.
3. Përpala marrjes së vendimit të revokimit, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërm bushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrit për ripërm bushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.
4. Urdhri i pezullimit revokohet nga organi kompetent, sipas legjisacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.
5. Licenca/autorizimi/leja, si rregull, revokohen:
 - a) kur rrëthanat janë të tillë, që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërm bushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;
 - b) në rast të mosbatimit të urdhërimeve, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;
 - c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantonhet nga titulli përkatës apo legjisacioni në fuqi.

Neni 13

Procedurat për nismat ligjore dhe nënligjore

në fushën e licencimit, të autorizimit dhe lejeve

1. Çdo nismë normative në fushën e licencimit/autorizimit/lejimit, sipas nenit 4 të këtij ligji, shpallet publikisht në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në faqen zyrtare të internetit dhe me mjete të tjera të përshtatshme, të paktën 30 ditë para shqyrtimit të tij përfundimtar nga organi miratues. Në rastin e projektligjeve, për të cilat të drejtën e nismës e ushtron Këshilli i Ministrave, shpallja bëhet 30 ditë përpala paraqitjes për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga ministri përgjegjës dhe ministri.
2. Shpallja, sipas pikës 1 të këtij neni, përban, të paktën, raportin e vlerësimit të pasojave, sipas pikës 5 të këtij neni dhe projekt-aktin përkatës.
3. Gjatë kësaj kohe, çdo organ tjetër publik, çdo palë e interesuar apo publiku mund të dërgojnë vërejtje. Brenda kësaj periudhe, organi nismëtar organizon, të paktën, një dëgjim publik, për t'u njojur me sugjerimet e organeve të tjera apo të palëve të interesuara.

4. Çdo nismë, sipas pikës 1 të këtij nenit, shoqërohet, në procesin e shqyrtimit dhe të miratimit, përvëç sa parashikohet nga legjislacioni në fuqi, edhe me këto dokumente:

- a) mendimin këshillimor të Qendrës Kombëtare të Licencimit;
- b) reportin e vlerësimit të pasojave.

5. Raporti i vlerësimit të pasojave përmban informacion të hollësishëm për objektivat dhe qëllimet e nismës, opsonet për arritjen e objektivave, krahasimin e opsoneve të ndryshme, pasojat e pritshme të opsonit të propozuar, përputhjen e opsonit të propozuar me secilin nga parimet e këtij ligji, një përbledhje të këshillimeve publike të zhvilluara dhe vërejtjet e propozimet e bëra gjatë këtyre këshillimeve.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rregulla të hollësishme për procedurën e vlerësimit të pasojave dhe përbajtjen e raportit përkatës.

KREU III

REGJISTRI KOMBËTAR I LICENCAVE DHE LEJEVE

Neni 14

Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve

1. Çdo licencë/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

2. Regjistri Kombëtar i Licencave dhe Lejeve është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

3. Regjistri organizohet në tri pjesë:

- a) regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve;
- b) regjistri informativ, sipas kategorive të licencave, autorizimeve dhe lejeve;
- c) regjistri aplikativ i licencave dhe lejeve.

4. Regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore përmban të gjitha projekt-aktet e nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve, reportin përkatës të vlerësimit të pasojave dhe mendimin këshillimor të QKL-së.

5. Regjistri informativ përmban, për çdo kategori licence/autorizimi/lejeje, të paktën, këto lloje të dhënash:

- a) kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- b) kriteret dhe detyrimet e licencimit, të autorizimit apo lejimit, dokumentet shoqëruar, që duhen paraqitur dhe formularët e aplikimit;
- c) procedurat e aplikimit, të shqyrtimit dhe vendimarrjes;
- ç) udhëzimet për bërjen e kërkësave.

6. Regjistri aplikativ përmban këto të dhëna:

- a) çdo kërkëse për pajisjen me licencë/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;
- b) çdo vendim të ndërmjetëm të institacioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përbushjes së kushteve të licencimit/lejimit;
- c) çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkëse;
- ç) çdo vendim për urdhërimin e ripërbushjes së kriterieve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licencës/lejes apo pezullimin e licencës/lejes;

- d) çdo vendim pér revokimin e një licence/leje;
- dh) çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë pér ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat "b" deri në "d" të kësaj pike;
- e) çdo licencë/leje të dhënë e të vlefshme;
- ë) vendimet e gjykatës, pér heqjen titullarit të një licence/lejeje të së drejtës, pér tē ushtruar veprimtarinë e licencuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të së mirës publike;
- f) çdo vendim tjetër pér një licencë/leje të caktuar.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës, përcakton kategoritë e autorizimeve, pjesë e regjistrat aplikativ dhe një apo disa nga të dhënat e parashikuara në pikën 6 të këtij nenit, që përfshihen në regjistrin aplikativ pér to.

8. Regjistri Kombëtar mbahet nga QKL-ja, e cila siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të tij. QKL-ja, çdo institucion i pavarrur dhe çdo institucion qendor, sipas shkronjës "b" të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, janë përgjegjës pér administrimin dhe plotësimin, sipas këtij ligji, të Regjistrat Kombëtar pér pjesën e licencave/autorizimeve/lejeve në kompetencë të tyre.

9. Organi nismëtar i nismës ligjore, me përjashtim kur është institucioni i përmendur në pikën 8 të këtij nenit, dërgon projekt-aktin dhe raportin e vlerësimit të pasojave pér publikim nga QKL-ja.

10. Çdo institucion tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, me kompetencë në shqyrtimin e kritereve të licencimit/autorizimit/lejes, ka akses në Regjistrin Kombëtar, pér tē publikuar vendimin e tij në procesin e shqyrtimit të kërkesës pér licencim/autorizim/leje.

11. Çdo institucion me kompetencia të caktuara pér trajtimin e një kërkesë ose me kompetencia inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankum administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses tē drejtpërdrejtë në regjistër, pér tē publikuar kërkesat, ankimet dhe vendimet përkatëse dhe është i detyruar pér tē publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përvçese kur parashikohet ndryshe në këtë ligji.

12. Vendimet e gjykatës, sipas shkronjave "dh" dhe "ë" të pikës 6 të këtij nenit, i njoftohen nga vetë gjykata, brenda 5 ditëve nga dhënia e tyre, institucionit që administrojn regjistrin pér licencën/autorizimin/lejen, sipas kompetencës përkatëse. Njoftimi bëhet me mjete tē përshtatshme.

13. Regjistri është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim tē tē dhënavë, tē cilat janë me akses tē kufizuar apo tē ndaluar, sipas legjislativit në fuqi.

14. Ministri miraton rregullat e hollësishme pér funksionimin e regjistrat, krijimin, administrimin, formatimin, përbajtjen, lidhjen në rrjet me institucionet e përfshira në procesin e licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe procedurat e sigurisë së tij.

KREU IV

KOMPETENCAT PËR TRAJTIMIN E LICENCAVE/AUTORIZIMEVE/LEJEVE

TE INSTITUCIONEVE QENDRORE

Neni 15

Kompetenca pér trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve

1. Licencat dhe lejet, sipas fushave dhe kategorive, në kompetencë të institucioneve qendrore, parashikohen në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Parashikimi i kategorive të tjera tē licencave/lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore, nga ato tē paparashikuara në shtojcë është i mundur vetëm nëpërmjet ndryshimit të kësaj shtojce.
3. Kërkesat pér licencat e lejet e parashikuara në shtojcë apo nënkategori të tyre trajtohen:
 - a) si rregull, nga apo nëpërmjet QKL-së;

- b) në raste të veçanta, nga organet e përcaktuara sipas legjislacionit përkatës në fuqi, pa përfshirjen e QKL-së.
4. Autorizimet, në kompetencë të institucioneve qendrore, përcaktohen nga legjislacioni në fuqi dhe kërkesat për trajtohen:
- si rregull, drejtpërdrejt nga institucionet kompetente, pa përfshirjen e QKL-së;
 - në raste të veçanta, nga apo nëpërmjet QKL-së.
5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, përcakton:
- nënkategori të licencave e të lejeve, të përcaktuara në shtojcë;
 - licencat, autorizimet dhe lejet apo nënkategori të tyre, kërkesat për të cilat trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, sipas kreut V të këtij ligji.

KREU V

PROCEDURAT E LICENCIMIT/AUTORIZIMIT/LEJIMIT NGA APO NPËRMJET QKL-SË

Sekzioni 1

NDARJA NË GRUPE

Neni 16

Grupet e licencave/autorizimeve/lejeve

- Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, miraton ndarjen e licencave, të autorizimeve dhe lejeve dhe/ose nënkategori të tyre, që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, në një nga tre grupet e përcaktuara në pikat 2, 3 e 4 të këtij nenit.
- Grupi i parë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kritereve bazohet vetëm në vetëdeklarimet e kërkuesit.
- Grupi i dytë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kritereve, përvçe se në vetëdeklarimet e kërkuesit, bazohet, për të paktën njërin nga kushtet, edhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuesi.
- Grupi i tretë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat, përvç sa parashikohet në pikat 2 e 3 të këtij nenit, vlerësimi i përmbushjes së kritereve, për të paktën njërin prej tyre, bazohet edhe në kryerjen e një procesi inspektimi, testim, gare, interviste, dëgjimi apo metode tjeter vlerësimi.

Sekzioni 2

KËRKESA, SHQYRTIMI DHE VENDIMMARRJA

Neni 17

Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje
për të gjitha grupet

- Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.
- Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.

3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna:

- a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë;
- b) llojin e veprimtarisë, veprimit apo të së mirës publike e të përdorimit të saj;
- c) të dhënat për identifikimin e kërkuesit dhe të personit që paraqet kërkesën;
- ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimit apo përdorimit të së mirës;
- d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë;
- dh) deklaratën e kërkuesit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);
- e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;
- ë) adresën për komunikim;
- f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 18

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e parë

1. QKL-ja merr në shqyrtim kërkesat për grupin e parë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 2 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

2. QKL-ja shqyrton:

- a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin, nëse është personi që mund të paraqesë kërkesën, sipas këtij ligji;
- b) plotësimin e plotë e të saktë të gjitha të dhënavë të detyrueshme, të kërkuara në formular;
- c) paraqitjen e të gjitha dokumenteve të tjera shoqëruese, nëse kërkohen;
- ç) përmbushjen apo jo të kritereve, përkatësisht, të licencimit/autorizimit/lejimit;
- d) pagesën e tarifës së shërbimit.

3. Shqyrtimi i përmbushjes së kritereve për grupin e parë, sipas shkronjës "ç" të pikës 2 të këtij nenit, bazohet vetëm në vetëdeklarimin e kërkuesit.

4. QKL-ja refuzon kërkesën nëse:

- a) personi, që ka paraqitur kërkesën, nuk është personi që mund të paraqesë kërkesën, sipas këtij ligji;
- b) formulari i plotësuar nuk është i plotë apo përmban korrigjime dhe përbajtja e tij nuk duket qartë apo është e palexueshme;
- c) nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese, ato nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përbajnjë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme;
- ç) kërkuesi nuk përmbush kriteret përkatëse të licencimit/autorizimit/lejimit;
- d) nuk është kryer pagesa e tarifës së shërbimit.

5. Nëse rast të kundërt, QKL-ja e miraton kërkesën.

Neni 19

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e dytë

1. QKL-ja shqyrton, sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji, kërkesat për grupin e dytë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 4 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës. QKL-ja shqyrton edhe paraqitjen e të gjitha dokumenteve provuese.
2. Vlerësimi i përbushjes së kritereve të licencimit/autorizimit/lejimit bazohet vetëm në vetëdeklarimet dhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuesi.
3. Refuzimi dhe miratimi i kërkesës bëhen për shkaqet, sipas pikave 4 e 5 të nenit 18 të këtij ligji.
4. Kërkesa refuzohet edhe nëse nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet provuese, ato nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përbajnjë korrigjime ose fshirje të pavërtetura, sipas dispozitive përkatëse, ose kur përbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme.

Neni 20

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë

1. QKL-ja merr në shqyrtim paraprak, sipas pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.
2. QKL-ja vlerëson vetëm përbushjen e kritereve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuesit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate, sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë. Vlerësimi i përbushjes së kritereve të tjera të licencimit/autorizimit/lejes bëhet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni.
3. Nëse QKL-ja konstaton njérën nga shkaqet e refuzimit, ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.
4. Në rast të kundërt, QKL-ja publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionet e tjera, që shqyrtojnë përbushjen e një apo të disa kritereve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencë të tyre.
5. Institucionet e tjera, brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përbushjen e kritereve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektime, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përbushjen ose mospërbushjen e kritereve përkatëse. Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.
6. Nëse akti i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është, paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtë kriteri apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institucion tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.
7. Afati i caktuar, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, është afati për shqyrtimin e përbushjes ose jo të kriterit përkatës nga institucioni tjetër dhe përcaktohet nga Këshilli i Ministrave për çdo kategori/nënkategori. Afati fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKL-së, sipas pikës 4 të këtij neni.
8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.
9. Jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i aftit të fundit dhe më të gjatë, sipas pikës 5 apo 6 të këtij neni, QKL-ja merr një vendim përfundimtar për kërkësen e paraqitur.
10. Nëse, qoftë edhe një nga institucionet e tjera ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKL-ja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundër QKL-ja vendos, përkatësisht, miratimin.

Neni 21

Kombinimi i procedurave

1. Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji nga apo nëpërmjet QKL-së dhe për të cilat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përbushjes së kritereve të licencimit/autorizimit/lejes bëhet për një

pjesë të kritereve që përpara fillimit të veprimtarisë, ndërsa vlerësimi i përbushjes së pjesës tjetër të kritereve bëhet vetëm pas një periudhe të caktuar të ushtrimit të veprimtarisë, trajtohen si më poshtë:

- a) procedura kalon në këta dy hapa: licencë/autorizim/leje e përkohshme dhe licencë/autorizim/leje përfundimtare;
- b) licenca/autorizimi/leja e përkohshme, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, është me afat të përcaktuar, sipas legjisacionit përkatës në fuqi dhe titullari duhet të paraqesë kërkesën për pajisjen me licencën/autorizimin/lejen përfundimtare, përpara përfundimit të afatit të asaj të përkohshme.

2. Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji, nga apo nëpërmjet QKL-së dhe për të cilat, sipas legjisacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përbushjes së kushteve të licencimit/autorizimit/lejimit bëhet me dy hapa dhe në hapin e dytë shqyrtohet vetëm kërkesa e subjektit që ka kaluar me sukses hapin e parë, trajtohen si më poshtë:

- a) procedura kalon në këta dy hapa: miratimi i kalimit me sukses të hapit të parë dhe licencimi/autorizimi/lejimi përfundimtar;
- b) pas njoftimit nga QKL-ja të vendimit të miratimit për kalimin me sukses të hapit të parë, kërkuesi duhet të paraqesë dokumentet shoqëruese për hapin e dytë brenda afatit përkatës.

3. Trajtimi i secilit prej hapave të parashikuar në shkronjën "a", përkatësisht, të pikave 1 e 2 të këtij nenit, u nënshtronhet, sipas rastit, procedurave të këtij ligji për grupin e parë, të dytë apo të tretë. Këshilli i Ministrave përcakton grupin, sipas të cilit trajtohet secili hap.

Neni 22

Përbajtja e vendimit dhe miratimi i heshtur

1. Vendimi i miratimit apo i refuzimit të kërkesës bëhet sipas formularit tip e njoftohet sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.
2. Vendimi i refuzimit përmban të gjitha shkaqet e refuzimit, ndërsa vendimi për miratim përmban edhe të dhënat e llogarinë bankare përkatëse, si dhe vlerën e taksës/tarifës që duhet paguar, nëse parashikohet nga legjisacioni në fuqi.
3. Vendimi i refuzimit, i bërë sipas pikës 10 të nenit 20 të këtij ligji, përmban edhe vendimin, sipas formularit tip të institucionit tjetër që ka vendosur refuzimin.
4. Riparaqitja e kërkesës pas refuzimit trajtohet si kërkesë e re.
5. Në rastin kur QKL-ja, brenda afatit të përcaktuar, sipas këtij kreu, nga paraqitja e kërkesës, nuk publikon vendimin e refuzimit apo të miratimit, atëherë kërkesa quhet automatikisht e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik gjeneron menjëherë vendimin e miratimit. Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik në regjistër.
6. Pika 5 e këtij nenit nuk zbatohet për kërkesat për grupin e tretë nëse edhe vetëm njëri nga institucionet e tjera, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, ka vendosur refuzimin.

Seksioni 3

TITULLI I LICENCËS/AUTORIZIMIT/LEJES DHE LËSHIMI I TIJ

Neni 23

Përbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.
2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna:
 - a) emrin dhe stemën e QKL-së;
 - b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;

- c) të dhënat për identifikimin e titullarit;
- ç) llojin e veprimitarisë, veprimit apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj;
- d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkatgorinë);
- dh) kufizimet në ushtrimin e veprimitarisë, në kryerjen e veprimit apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka);
- e) afatin e vlefshmërisë;
- ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit;
- f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkatgorisë;
- g) aneksin.

3. Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjisacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

Neni 24

Hyrja në fuqi e licencës/autorizimit/lejes dhe prova e tij

1. Licenca, autorizimi apo leja hyn në fuqi menjëherë, me publikimin e titullit përkatës në regjistër, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

2. Në rastet kur për përfitimin e titullit nuk është e zbatueshme një tarifë apo taksë, titulli publikohet në regjistër menjëherë dhe automatikisht, së bashku me njoftimin e vendimit të miratimit, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji, apo menjëherë me gjenerimin e miratimit të heshtur, sipas pikës 5 të nenit 22 të këtij ligji dhe mund të tërhiqet në çdo sportel shërbimi të QKL-së apo të printohet drejtpërdrejt nga regjistri.

3. Në rastet kur për përfitimin e titullit është e zbatueshme një tarifë apo taksë:

a) QKL-ja bën, menjëherë, shënimin përkatës në regjistër nëse kërkuesi paraqet dokumentin e pagesës së taksës/tarifës. Titulli publikohet automatikisht dhe menjëherë në regjistër dhe mund të tërhiqet në çdo sportel shërbimi të QKL-së apo të printohet drejtpërdrejt nga regjistri;

b) vendimi i miratimit, së bashku me dokumentin e pagesës së taksës/tarifës, zëvendësojnë titullin përkatës nëse QKL-ja nuk bën shënimin e pagesës së taksës/tarifës.

4. Nëse aplikohet një taksë apo tarifë dhe kërkuesi nuk paraqet provën e pagesës brenda afatit 30 ditë kalendare, nga publikimi i vendimit të miratimit, titulli vlerësohet automatikisht i revokuar dhe QKL-ja bën shënimin përkatës në regjistër, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

Neni 25

Zëvendësimi i titullit

1. Në rast humbjeje apo dëmtimi të titullit, titullari njofton QKL-në dhe i kérkon zëvendësimin e titullit. Kërkesa bëhet sipas procedurave të këtij ligji dhe formularit të miratuar.

2. QKL-ja anulon titullin dhe e zëvendëson atë brenda 2 ditëve pune nga data e paraqitjes së kérkesës, duke bërë edhe shënimin përkatës në regjistër.

Sekzioni 4

NDRYSHIMET, SHTYRJA E AFATIT DHE REVOKIMI

Neni 26

Ndryshimi i të dhënave të titullit, që nuk kanë të bëjnë me kriteret

1. Kur përgjatë kryerjes së veprimit apo përdorimit të së mirës ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titull e të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, ky ndryshim i njoftohet, brenda 30 ditëve, QKL-së, me kërkesë të titullarit.
2. Kërkesa bëhet sipas procedurave të përcaktuara për grupin e parë dhe duhet të përmbajë të dhënrat e reja, që kerkohen të ndryshohen.
3. Kur QKL-ja vëren se ka të bëjë me një rast të tillë, bën ndryshimet përkatëse dhe lëshon titullin e ndryshuar brenda 2 ditëve nga data e bërjes së kërkesës.

Neni 27

Ndryshimi i të dhënave të titullit, që kanë të bëjnë me kriteret

1. Kur përgjatë kryerjes së veprimit apo përdorimit të së mirës ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin përkatës e të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, ky ndryshim pavarësisht se mund të cenojë apo jo këto kritere, duhet t'u njoftohet nga titullari i titullit, menjëherë QKL-së dhe institucioneve të tjera përkatëse, që kanë marrë pjesë në dhënen e atij titulli. Kur ndryshimet janë të tillë, që mund të cenojnë kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit, titullari duhet të pezullojë, me nismën e vet, veprimitarë, veprimin apo përdorimin e së mirës publike.
2. Titullari duhet të kërkojë verifikimin, nëse këto ndryshime çojnë në vazhdimin e vlefshmërisë së titullit me ndryshimet përkatëse apo në revokimin e tij.
3. Kërkesa për të dhënrat që ndryshojnë bëhet sipas nenit 17 të këtij ligji dhe shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, sipas të njëjtit grup, për të cilin është bërë kërkesa për vetë titullin.
4. Kur vlerësohet se ndryshimet e ndodhura nuk cenojnë kriteret, titullari pajiset me titullin e ndryshuar, afati i vlefshmërisë së të cilit mbaron në të njëjtën datë me atë të titullit të mëparshëm.
5. Kur vlerësohet, sipas këtij ligji, se ndryshimet e ndodhura cenojnë kriteret, titulli revokohet.

Neni 28

Shtyrja e afatit të licencës/autorizimit/lejes

1. Shtyrja e afatit të titullit është e mundur vetëm kur është parashikuar në legjislacionin e posaçëm dhe vetëm në bazë të kushteve të parashikuara në të.
2. Kërkesa për shtyrjen e afatit trajtohet e shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, e të njëjtit grup, sipas këtij ligji.

Neni 29

Revokimi i licencës/autorizimit/lejes

1. Titujt e lëshuar, sipas këtij kreu, revokohen sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.
2. Titulli revokohet edhe nga QKL-ja në këto raste:
 - a) me kërkesë të titullarit;
 - b) për mospagim të taksës/tarifës përkatëse (nëse ka);
 - c) për konstatim të të dhënave të pavërteta në dokumentet e paraqitura në QKL;
 - ç) për mosnjoftim të ndryshimit të të dhënave, sipas nenit 26 apo 27 të këtij ligji.
3. QKL-ja merr vendimin për revokimin e titullit në afatin e 2 ditëve pune nga përcaktimi i shkaqeve të revokimit.

4. Në rastin e revokimit të titullit, taksa/tarifa e paguar nuk kthehet.

Seksioni 5

ANKIMI

Neni 30

Ankimi

1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të QKL-së apo institucionit tjetër në rastin e grupit të tretë.

2. Ankimi administrativ shqyrtohet nga titullari i QKL-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të këtij nenii.

3. Në rastin e refuzimit të parashikuar në pikën 10 të nenit 20 të këtij ligji, ankimi shqyrtohet nga institacioni tjetër, që e ka vendosur refuzimin.

4. Ankimi, në të gjitha rastet, paraqitet me kërkesë në QKL, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, QKL-ja publikon ankimin dhe njofton, në mënyrë elektronike, institacionin tjetër kompetent.

5. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ apo mosveprimit mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Seksioni 6

MËNYRAT E PARAQITJES SË KËRKESAVE E NJOFTIMEVE NË DHE NGA QKL-JA, PUBLIKIMET DHE MIRATIMI I AKTEVE TË TJERA NËNLIGJORE

Neni 31

Paraqitja e kërkesave në QKL

Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës/taksës në QKL mund të kryhen nëpërmjet:

- a) paraqitjes drejtpërdrejt në çdo sportel shërbimi të QKL-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së kërkuesit;
- b) dërgimit me postë me lajmërim-marrje në selinë qendrore të QKL-së;
- c) dërgimit me mjete elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik.

Neni 32

Paraqitja në sportelit e QKL-së

1. Kërkesa paraqitet në sportelin e QKL-së nga vetë kërkuesi apo çdo person i autorizuar prej tij.

2. Nëpunësi i sportelit asiston të interesuarin në plotësimin e formularit të kërkesës, verifikon identitetin dhe kërkon nënshkrimin e formularit të plotësuar.

3. Dokumentet shoqëruese paraqiten në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin apo në kopje të shoqëruara me origjinalin, që njësohen me origjinalin nga nëpunësi i sportelit.

4. Kur kërkesa paraqitet nga personi i autorizuar, sipas pikës 1 të këtij neni, bashkë me dokumentet shoqëruese paraqitet edhe dokumenti që vërteton faktin e të qenit i autorizuar.

5. Nëpunësi i sportelit lëshon një konfirmim, me shkrim, për çdo kërkesë. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë llojin e kërkesës, datën dhe listën e dokumenteve shoqëruese të dorëzuara.

6. Nëpunësi i sportelit është i detyruar të marrë në dorëzim çdo kërkesë të paraqitur, sipas këtij ligji, edhe nëse kërkesa është e paplotë.

7. Dokumenti i pagesës së tarifës/taksës paraqitet në sportel, nëpunësi i të cilit lëshon një konfirmim me shkrim.

Neni 33

Paraqitura me postë

1. Kërkesat dhe paraqitura e dokumentit të pagesës së tarifës/taksës së licencës/autorizimit/lejes në QKL mund të kryhen edhe me postë me lajmërim-marrje.

2. Formulari i plotësuar i kërkesës/njoftimit, në rastin e paraqitjes me postë, nënshkruhet nga personat përgjegjës, për përfaqësimin e personit juridik apo vetë personi fizik.

3. Dokumentet bashkëlidhur paraqiten në kopje të njësuara me origjinalin.

4. Bashkë me dokumentet shoqëruese paraqitet edhe një kopje e dokumentit të identifikimit të personit që ka nënshkruar formularin.

5. Në bazë të marrëveshjes me organet e shërbimit postar, nëpunësi i shërbimit postar lëshon konfirmimin, sipas pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

6. Data e paraqitjes së kërkesës në QKL është data e përcaktuar në lajmërim-marrje.

Neni 34

Njoftimi i vendimeve nga QKL-ja dhe dorëzimi i titullit

1. Vendimet e QKL-së, sipas këtij ligji, njoftohen nëpërmjet publikimit në regjistër.

2. Data e njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është data e publikimit në regjistër.

3. Titulli përkatës i dorëzohet kërkuesit në sportel.

Neni 35

Afati i publikimi në regjistër

Çdo kërkesë dhe çdo vendim i QKL-së apo i një institucioni tjeter, që lidhet me licencimin/autorizimin/lejimin, sipas këtij kreu, publikohet në regjistër brenda ditës së nesërme të punës nga paraqitura e kërkesës apo marrja e vendimit ose e bërjes me dije.

Neni 36

Miratimi i procedurave dhe i formave standarde

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, miraton:

a) procedurat e hollësishme të trajtimit të kërkesave të licencave/autorizimeve/lejeve dhe të nënkatgorive të tyre;

- b) kriteret e posaçme të licencimit/autorizimit/lejimit për secilën nga kategoritë e nënkategori, dokumentet shoqëruesh, formët dhe përbajtjen e dokumenteve shoqëruese, si dhe afatin e vlefshmërisë së titullit përkatës;
- c) detyrimet e posaçme të licencimit/autorizimit/lejimit për secilën nga kategoritë e nënkategori e tyre, sipas delegimit nga legjisacioni përkatës i posaçëm;
- ç) institucionet e tjera kompetente, që vlerësojnë përbushjen e kritereve, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, si dhe metodat e afatet përkatëse;
- d) aktet e tjera nënligjore, të përcaktuara në këtë kre.

2. Ministri, së bashku me ministrin përgjegjës miratojnë:

- a) formularët e kërkesave me përbajtjen e hollësishme të rubrikave të tyre, për çdo kategori e nënkategori të licencave/autorizimeve/lejeve;
- b) formularët për titujt e licencave/autorizimeve/lejeve dhe të anekseve përkatëse.

3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKL-së, miraton formularët për llojet e tjera të kërkesave, të njoftimeve që bëhen në QKL, sipas këtij ligji, si dhe ato të vendimeve të QKL-së.

KREU VI

KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QKL-SË

Neni 37

Krijimi dhe statusi

1. Krijohet Qendra Kombëtare e Licencimit.
2. QKL-ja është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit, me seli në Tiranë.
3. QKL-ja financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta.
4. QKL-ja ka pavarësi të plotë në vendimmarrje përfunksionet e veta, të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji.

Neni 38

Funksionet e QKL-së

QKL-ja ka këto funksione:

- a) trajton procedurat e licencimit/autorizimit/lejeve, ndryshimit dhe revokimit, sipas këtij ligji;
 - b) mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave e Lejeve;
 - c) siguron aksesin e lirë të publikut, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
 - ç) informon dhe këshillon kërkuesit dhe publikun për procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit;
 - d) jep mendim për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e licencave/autorizimeve/lejeve;
- dh) kryen studime për cilësinë e mjedisit rregulator, mbështet me informacion, analiza e këshilla institucionet qendrore dhe të pavarura, për nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e licencave, autorizimeve e lejeve dhe ministrinë dhe/ose Këshillin e Ministrave në politikat përmirësimin e mjedisit rregulator.

Neni 39

Organizimi i QKL-së

1. QKL-ja është institucion unik dhe ushtron juridiksonin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. QKL-ja ofron shërbimin ndaj publikut, në mënyrë të drejtpërdrejtë, me sportelet në selinë e saj, sportelet e shërbimit të krijuara në territor, sportelet e shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore apo në institacione e ente të tjera, publike apo private.
3. Njësitë e qeverisjes vendore, ku krijohen dhe funksionojnë shërbimet e sportelit, përcaktohen nga QKL-ja dhe janë të detyruara të krijojnë sportelet, sipas këtij ligji.
4. Në njësitë e qeverisjes vendore, përcaktuar sipas pikës 3 të këtij neni, shërbimi i sportelit kryhet si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e këtij ligj dhe të legjisacionit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
5. Ngritja e sporteve në institucionet dhe entet e tjera publike apo private bëhet nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse me QKL-në, pas miratimit paraprak të ministrit.

Neni 40

Drejtimi i QKL-së

1. Veprimtaria e QKL-së drejtohet nga titullari.
2. Titullari është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar e të burimeve njerëzore të QKL-së.
3. Titullari përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët.
4. Titullari i QKL-së ushtron udhëheqjen metodologjike dhe nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për nepunësit e QKL-së, si dhe për nepunësit e sporteve të shërbimit, për ushtrimin e funksionit të deleguar.

Neni 41

Numri i punonjësve dhe struktura e QKL-së

1. Numri i punonjësve të QKL-së miratohet nga Këshilli i Ministrave, si zë më vete, në përputhje me ligjin për Buxhetin vjetor të Shtetit.
2. Struktura dhe organika e QKL-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit, në përputhje me legjisacionin në fuqi.

Neni 42

Statusi i titullarit të QKL-së

1. Titullari i QKL-së emërohet nga ministri, në përputhje me legjisacionin në fuqi.
2. Titullari i QKL-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nepunësit civil".
3. Titullari i QKL-së lirohet nga detyra për shkaqet dhe sipas procedurave të parashikuara në pikën 1 të nenit 21 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nepunësit civil". Vendimi për lirimin e titullarit merret nga ministri.
4. Titullari i QKL-së i nënshtrohet dispozitave që rregullojnë masat, procedurat disiplinore dhe vlerësimin e punës, sipas parashikimeve në legjisacionin për nepunësin civil. Ministri është "eprori direkt", në kuptimin e këtyre dispozitave.
5. Kundër vendimit të ministrit për aktet e nxjerra në bazë të pikave 1 deri në 4 të këtij neni, ankimi bëhet drejtpërdrejt në gjykatën kompetente.

Neni 43

Nëpunësit dhe punonjësit e QKL-së

1. Për nëpunësit e QKL-së zbatohen procedurat e legjislacionit pér nëpunësin civil, të parashikuara pér institucionet e pavarura, pérveç sa parashikohet ndryshe në këtë ligj. Titullari i QKL-së është "eprori direkt", në përputhje me këto dispozita.
2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të QKL-së, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshém në administratën publike.
3. Ankimi ndaj akteve të titullarit, të nxjerra në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij nenit, bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 44

Nëpunësit e sporteve në njësitë e qeverisjes vendore

1. Nëpunësit e sporteve të shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore, ku ato krijohen, janë nëpunës të njësive vendore përkatëse.
2. Njësia e qeverisjes vendore përkatëse cakton nëpunësin e sportelit pas miratimit paraprak të titullarit të QKL-së. Miratimi paraprak jepet jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së propozimeve nga njësia vendore.
3. Titullari i QKL-së përcakton kriteret e posaçme profesionale, që duhet të plotësojnë këta nëpunës dhe siguron trajnimin profesional të tyre, pér kryerjen e funksionit të deleguar, sipas këtij ligji.
4. Titullari i QKL-së kërkon zëvendësimin e nëpunësit, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën, sipas treguesve të cilësisë të QKL-së.
5. Njësia e qeverisjes vendore është e detyruar ta zëvendësojë nëpunësin e sportelit menjëherë pas kërkesës së titullarit të QKL-së.

Neni 45

Pagat e QKL-së

1. Struktura dhe nivelet e pagave dhe të shpërbimit të QKL-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Niveli i pagave dhe i shpërbimit, si dhe numri i nëpunësve në sportet e shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore përcaktohen nga këshillat përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 46

Buxheti i QKL-së

1. Buxheti i QKL-së është zë më vete në Buxhetin e Shtetit.
2. Projektbuxheti vjetor dhe afatmesëm i QKL-së përgatitet nga titullari i saj dhe propozohet pas miratimit nga ministri.
3. Buxheti përbëhet nga të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e QKL-së, përfshirë edhe fondet pér shpenzime operative dhe kapitale pér sportet e shërbimit dhe të ardhurat, që krijohen në këto sportete.
4. Fondet pér shpenzime operative, pér çdo sportel, në njësinë e qeverisjes vendore, janë fonde të kushtëzuara. Ato përcaktohen në buxhetin e QKL-së, bazuar në kritere të drejta e objektive, në përputhje me vlerësimin paraprak të ngarkesës operative të çdo sporteli dhe të treguesve të cilësisë së shërbimit dhe i jepen njësisë përkatëse në formën e një shume totale të kushtëzuar.
5. Shpenzimet kapitale pér pajisjet në sportet e shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore kryhen nga QKL-ja.

6. Njësia e qeverisjes vendore, në përputhje me objektivin e saj, mund të parashikojë dhe të kryejë shpenzime operative ose kapitale shtesë për përmirësimin e shërbimeve të sportelit.

Neni 47

Shërbimet e tarifat e QKL-së

1. QKL-ja realizon të ardhura nga kryerja e funksioneve të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera, në mbështetje të këtyre funksioneve.
2. Ministri përcakton shërbimet e tjera, që ofrohen nga QKL-ja, tarifat e të cilave miratohen, me propozimin e tij, nga Ministri i Financave.
3. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet, që lidhen me kryerjen e detyrave funksionale, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.
4. Të gjitha tarifat shpallen në çdo sportel shërbimi dhe në faqen e internetit të QKL-së.

Neni 48

Përdorimi i të ardhurave të veta nga QKL-ja

1. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për kryerjen e funksioneve, sipas këtij ligji, përfshirë edhe ato të krijuara në sportelet e shërbimit, derdhen në Buxhetin e Shtetit.
2. Të ardhurat nga tarifat për shërbimet e tjera, të krijuara nga QKL-ja ose nga sportelet e shërbimit, derdhen vetëm në masën 90 për qind në Buxhetin e Shtetit, ndërsa 10 për qind përdoret nga QKL-ja për përmirësimin e funksionimit e të shërbimit të QKL-së.
3. QKL-ja mban llogaritë në thesar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 49

Auditimi i QKL-së

Veprimtaria financiare e QKL-së auditohet nga strukturat e ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 50

Raportimi dhe përgjegjshmëria

1. Ministri miraton objektivat specifikë të punës dhe treguesit e cilësisë së shërbimeve që kryen QKL-ja dhe mbikëqyr arritjen e tyre.
2. QKL-ja i raporton ministrit për menaxhimin administrativ, financier dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve sa herë që i kërkon, por jo më pak se një herë në vit.

Neni 51

Statuti i QKL-së

Këshilli i Ministrave, në përputhje me parimet e këtij ligji, me propozimin e ministrit, miraton statutin e QKL-së, që përfshin rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e saj, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve, mënyrën e raportimit, marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe lidhjen e marrëveshjeve për sportelet e shërbimit.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT
HYRJA NË FUQI

Neni 52

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë ndryshimet në të gjitha ligjet e tjera, për aq sa është e nevojshme, për sigurimin e koherencës ligjore me këtë ligj dhe t'i paraqesë ato Kuvendit në trajtën e një pakete të vetme.
2. Ngarkohen Këshilli i Ministrave, ministri dhe ministri përgjegjës që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj.
3. Ngarkohen Këshilli i Ministrave, ministrat dhe organet e tjetra që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të posaçme, të miratojnë akte normative nënligjore në fushën e lejeve, të autorizimeve dhe licencave dhe të përshtatin aktet nënligjore, sipas rastit, në përputhje me parimet dhe dispozitat e këtij ligji.

Neni 53

Dispozita kalimtare

1. Licencat/autorizimet/lejet kompetencë e institucioneve qendrore, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin, për të cilin janë lëshuar.
2. Ngarkohen të gjitha institucionet qendrore, që kanë lëshuar licenca/autorizime/leje deri në afatin e parashikuar në pikën 2 të nenit 55 të këtij ligji e që të cilat, sipas këtij ligji, trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së, t'i dërgojnë QKL-së të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin që publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave e Lejeve, brenda këtij afati.
3. Ngarkohen të gjitha institucionet e pavarura dhe institucionet qendrore, të përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, të publikojnë, brenda datës 31 dhjetor 2009, në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e përcaktuar, sipas parashikimeve të këtij ligji për licencat/autorizimet/lejet e vlefshme e të dhëna prej tyre deri në këtë datë.
4. Deri në bërjen funksional të sistemit elektronik të komunikimit me QKL-në, për grupin e tretë të licencave/autorizimeve/lejeve, afateve të parashikuara për:
 - a) publikimin e vendimit paraprak nga QKL-ja, sipas pikës 4 të nenit 20 të këtij ligji;
 - b) publikimin e vendimit të institucionit tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji;t'u shtohen, përkatësisht, nga 2 ditë kalendarike për dërgimin/marrjen e vendimit me postë me lajmërim-marrje.

Neni 54

Shfuqizime

Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 55

Fillimi i efekteve

1. Krerët I, II, IV, VI e VII i shtrijnë efektet menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. QKL-ja fillon trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve, në përputhje me këtë ligj dhe kreun V të tij, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, por jo më vonë se data 31.5.2009.
3. Institucionet qendore kompetente për trajtimin e licencave/autorizimeve/lejeve, sipas legjislacionit përkatës, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të pranojnë kërkesa dhe t'i trajtojnë ato deri në datën e fillimit të trajtimit nga QKL-ja, sipas pikës 2 të këtij nenit. Kërkesat në proces dhe të papërfunduara deri në këtë datë trajtohen nga institucionet përkatëse, në përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkuesi tërheq kërkesën dhe vendos ta paraqesë atë pranë QKL-së.
4. Kreu III i shtrin efektet për institucionet pavarura dhe institucionet qendore, të përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, në datën 31 dhjetor 2009.

Neni 56

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6088, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Bamir Topi